

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 35 paragrafi 1 alineja 6 dhe nenit 37 paragrafi 1 alineja 14 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019), më 19.10.2021, nxori këtë:

KONKLUZION

Anëtar i Këshillit gjyqësor, këshilltar shtetërorë, dhe të punësuar të tjerë në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 8 dhe nenit 40 të Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk janë të autorizuar që ti nënshkruajnë shkresat me shkrim drejtuar Kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për shkresat e tilla Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, NUK DO TË VEPROJË.

Këshilli gjyqësor nuk ka kompetencë që del nga neni 36 i Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të kërkojë t’i dorëzohet raport për lëndë të parashkuara dhe për lëndë të pa kryera të vjetra dhe atë sipas viteve, llojit dhe gjyqtarëve, me shtesë deklarata të gjyqtarëve, të cilët punojnë me lëndët me sqarime të arsyetuara lidhur me procedimin e deritanishëm me ato lëndë, si dhe arsye për shkaktimin e parashkrimit dhe mos kryerjen e lëndëve të vjetra. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk do të veprojë për kërkesën e parashtruar për dorëzimin e të dhënave të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.03-1571/1 të datës 13.10.2021, të nënshkruar nga anëtar i Këshillit gjyqësor dhe për arsyet që përfshihen në paragrafin 1 të Konkluzionit.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme